

VENDIM
Nr. 10, datë 3.3.2023

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME
FIER SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence” (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, e ndryshuar (rregullore e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 3.3.2023 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e vendimit ‘Për licencimin e shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Fier sh.a.’”,

KONSTATON SE:

1. Shoqëria rajonale Ujësjellës-Kanalizime Fier sh.a., me shkresën nr. 680 prot. datë 10.2.2023, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për licencim.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim të shoqërisë rajonale UK Fier sh.a. në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe rregulloren e licencimit, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 302, datë 11.5.2022, “Për politikat kombëtare për riorganizimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit, Trajtimit dhe Përpunimit të Ujërave të Ndotura” (VKM nr. 302).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) shoqëria rajonale Ujësjellës-Kanalizime Fier sh.a., me (NUIS M23315402G) është themeluar më datë 8.9.2022, me aksionarë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me 51% dhe bashkitë Fier me 33.99 %, Patos me 5.21%, Roskovec me 4.31 % dhe Mallakastër me 5.49%;

b) shoqëria rajonale UK Fier sh.a. ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 225 721 banorë të bashkive Fier, Patos, Roskovec, Mallakastër;

c) drejtues teknik i shoqërisë z. Artur Baxhia është diplomuar në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Gjeologjisë së Minierave në vitin 1995 dhe plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për herë të parë ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e shoqërisë rajonale UK Fier sh.a., të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102 si dhe kuadrin rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121) për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes, veçanërisht, në lidhje me kufizimin e tregjeve;

5. ERRU-ja, në bazë të vlerësimit dhe verifikimeve të kërkesës së shoqërisë rajonale UK Fier rekomandon:

a) Shoqëria rajonale UK Fier, duhet të pajiset me akt miratimet higjieno-sanitare të rinovuara/azhurnuara për të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë rajonale UK Fier.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e shoqërisë rajonale UK Fier sh.a. është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Fier sh.a., me (NUIS M23315402G), në kategoritë:

a) kategoria A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

b) kategoria C - Për largimin e ujërave të ndotura;

2. Shoqëria rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Fier sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

a) drejtues ligjor: z. Petrit Kanani;

b) drejtues teknik: z. Artur Baxhia.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Fier sh.a. janë bashkitë Fier, Patos, Roskovec, Mallakastër.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 2-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Fier sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Fier sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

7. Vendimi i KKRR-së nr. 120, datë 20.10.2020, "Për licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Fier sh.a.", shfuqizohet. Vendimi i KKRR-së nr. 429, datë 11.11.2021, "Për licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Roskovec sh.a.", shfuqizohet. Vendimi i KKRR-së nr. 37, datë 11.7.2019, "Për licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Mallakastër sh.a.", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani